



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

---

Numri i lëndës: 2021:249845  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05747416

**K.Dh.Sh.II.nr.219/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike të kreditorit Pro Credit Bank sh.a., me seli në Prishtinë, rr. “George Bush”, nr.26, kundër debitorëve “PTP Metal”, me seli në Zvecan, rr. Prvog nr.90, B.N. me adresë në rr. ...., Zvecan, T.M., me adresë në rr. ..., M.R. me adresë në Mitorovicë, rr. ..., nr. 17, lidhur me çështjen përmbartimore për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti të Përgjithshme, PPP.nr.164/19 i datës 19.04.2021, me datën 28.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e kreditorit Pro Credit Bank sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti të Përgjithshme, PPP.nr.164/19 i datës 19.04.2021, **PRISHET**, dhe Çështja i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti të Përgjithshme, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.164/19 i datës 19.04.2021, e ka miratuar si të bazuar prapësimin e debitorit M.R. me adresë në Mitrovicë, ashtu që e ka shfuqizuar urdhërin për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit privat Atip Mustafa P.nr.1173/18 të datës 26.11.2018.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike, për shkak të shkeljës së dispozitave të procedurës përbarimore, si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, që të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.164/19 i datës 19.04.2021 ashtu që të pranohet në tërësi ankesa e debitorit si e bazuar, dhe urdhëri i përbaruesi privat P.nr.1173/18 të datës 26.11.2018, të mbetet në fuqi, apo çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, por i njëjti nuk ka parashtuar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Pro Credit Bank sh.a., me seli në Prishtinë, me datën 26.11.2018 ka paraqitur propozimin për përbarim në bazë të dokumentit të besueshme Marrëveshjes se kredisë, për borxhin në vlerën prej 1,142.971€, si dhe ka kërkuar të gjitha shpenzimet e përbarimit nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Përbaruesi Privat Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr.1173/18, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 15.01.2019, ka ushtruar prapësim duke theksuar se me Urdhrin Përbarimor të iniciuar në bazë të dokumentit të besueshme, duke deklaruar nuk janë përmbushur kushtet për përdorimin e kredisë, sepse nuk jam as përfitues i kredisë e as debitor, vetëm jam pengë dhënës i pjesës së pestë, i ka propozuar gjykatës që të miratohet prapësimi i debitorit si i themeltë dhe të refuzohet Urdhri Përbarimor me shenjen P.nr.1173/18 të datës 26.11.2018.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar pala kreditore, duke theksuar se kundërshtimi i debitorit është i paargumentuar dhe i pabazuar, andaj i ka propozuar gjykatës që të mbetet në fuqi Urdhri i përmbaruesit privat për caktimin e përmbarimit P.nr.1173/18 të datës 26.11.2018.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.164/19 i datës 19.04.2021, e ka miratuar si të bazuar prapësimin e debitorit M.R. me adresë në Mitrovicë, ashtu që e ka shfuqizuar urdhërin për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat Atip Mustafa P.nr.1173/18 të datës 26.11.2018.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me dispozitat e nenit 39 para.1 të cilën përcaktohet se *“Në qoftë se në bazë të dokumentit përmbarimorë dy apo më tepër debitor janë përgjegjës solidar, organi përmbarues, kundër tyre do të nxjerrë vetëm një aktvendim për përmbarimin, me të cilin bëhet sekuestrimi i llogarisë së debitorëve në shumat e caktuara me anë të aktvendimit apo urdhrit për përmbarimin”*, ndërsa sipas para.2 të këtij neni përcaktohet se *“Propozuesi mund ta caktojë në propozimin për përmbarimin radhën e debitorëve sipas të cilës do të bëhet marrja e mjeteve nga debitorët, e në qoftë se ai nuk e ka bërë këtë, marrja e mjeteve do të bëhet sipas asaj radhe që janë përmendur debitorët në propozimin për përmbarim”*. Prandaj gjykata ka gjetur se përmbaruesi privat si organ përmbarimor nuk i ka ndërmarr të gjitha veprimet për të ekzekutuar urdhërin e sjellë në pronën e debitorëve të rendit të parë, për të cilën thekson parashtruesi i prapësimit, prandaj, gjykata e shkallës së parë si në rastin konkret, ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenin 39 par.1 dhe 2 të LPP-së, si dhe në dispozitën e nenit 73 të LPP –së.

Gjykata Komerciale vlerëson se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 pika (n) të LPK, për arsye se i njëjti nuk është i kuptueshëm, i qartë dhe se nuk përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që nuk mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës përmbarimore

dhe për shkak të hetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e cila vihet në dyshim me pretendim ankimor, gjykata përbarimore gabimisht e ka aplikuar edhe të drejtën materiale.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson së gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar drejtën materiale, kur e ka aplikuar depozitën e nenit 39 par.1 dhe 2 të LPP-së, pasi që nuk e ka vlerësuar në mënyrë të kjuartë marrëveshjen e lidhur mes kreditorit dhe debitorëve në bazë të dokumentit për të cilën është iniciuar urdhëri përbarimor, si dhe nuk ka vlerësuar se a përbën bazën juridike për caktimin e përbarimit, dhe se a paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, në të cilin përcaktohet se: “ *Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”.

Kjo Gjykate vlerëson se nga shkresat e lëndën rezulton se debitori – hipotekëlënësi Marko Radomirovic ka nënshkruar Kontratën e Kredisë dhe Hipotekës, ku me nenin 3 të kësaj kontratë hipotekëlënësi ka deklaruar shprehimisht dhe ku ka nënshkruar këtë kontratë duke e kuptuar detyrimet që do të dalin nga ky raport kontraktual që rezulton së në rast të mos pagesës nga palët kontraktuese, pronat e tij mund të jetë objekt përmes përbarimit në rast të mos përmbushjes së obligimit. Prandaj, në këtë çështje përbarimore gjykata e shkallës së parë fare nuk ka vlerësuar se debitori a mund të lirohet nga përgjegjësi e tij për pagimin e obligimeve të dalura nga kontrata, e po ashtu nuk ka vlerësuar as dispozitat e nenit 10.1 dhe 10.2 të LPP-së , si dhe kontrata e kredisë a e ka cilësinë e dokumentit përbarues sipas nenit 21 dhe 22 par.1.7, LPP-së.

Andaj në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata e shkallës së dytë duke e pranuar si të themeltë pretendimin ankimor në këtë drejtim, çështjen vendosi t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vlerësojë edhe njëherë pretendimet e palës debitore lidhur me prapësimin e tij, Kontratën e kredisë të lidhur në mes kreditorit dhe debitorëve, respektivisht të vlerësojë se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përbarimit nga ana e përbaruesit privat, e më pas ka mundësi që të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.Dh.Shk.II.nr.219/23, me datën 28.05.2024

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija-Ymeri